Botuesi:

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Përktheu dhe lekturoi:

Renata B. Asani

Dizajni dhe renditja teknike:

Litera Group ShPKNjP - Shkup

Shtypi:

Litera Group ShPKNjP - Shkup

Tirazhi:

300

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 5

PJESA 1 7

1.1. Hyrje 7

1.2. Historia e AZGJ-së 8

1.3. Misioni dhe vizioni 8

PJESA 2 10

2.1. Statusi 10

2.2. Udhëheqja 10

2.3. Kompetencat ligjore të AZGj-së 10

2.4. Parimet dhe vlerat e punës 11

PJESA 3 12

3.1. Vendosja organizative 12

3.2. Burimet njerëzore 13

3.3. Struktura e të punësuarve 17

PJESA 4 20

4.1. Vështrim i punës 20

4.2. Përkthim dhe lekturim 21

Gjatë vitit 2023, në AZGJ janë dorëzuar 510 kërkesa për përkthim dhe 256 kërkesa për lekturim të akteve dhe dokumenteve zyrtare. 21

4.3. Pyetësorët anketues drejtuar institucioneve të sektorit publik 21

4.4 Regjistri (baza e të dhënave) 26

4.5. Trajnim për përkthyesit dhe për lektorët e sektorit publik 26

4.6. Parashtresat e pranuara 29

4.7. Informimi 29

4.8. Buletini periodik 29

4.9. Ueb faqja zyrtare dhe mediet digjitale 31

4.10 Fjalori elektronik VERBIS....32
4.11. Publikime të shtypura dhe elektronike....33
4.12 Aktet e nënshkruara të bashkëpunimit....34
4.13 Pasqyrë e akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" në vitin 2023....37
PJESA 5....43
5.1. Buxheti, llogaria përfundimtare dhe financimi....43
5.2. Furnizimet publike....45
PJESA 6....47
6.1. Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara....47
REKOMANDIME....94

PARATHËNIE



Para jush është Raporti i pestë vjetor i punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AZGJ) për vitin 2023. Ky dokument është një pasqyrë gjithëpërfshirëse e aktiviteteve dhe përpjekjeve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në mbështetje të të gjitha autoriteteve shtetërore në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve, promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, mbrojtjen e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve si dhe forcimin e kapaciteteve për përkthim nga ana e institucioneve, po ashtu përkrahjen e të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të mundësohet realizimi i të drejtave të qytetarëve në përputhje me ligjin.

Viti që kaloi ishte një vit tjetër i punës intensive dhe veprimit aktiv në avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe në avancimin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/ 2019).

Në vitin 2023, AZGj-ja arriti të realizojë një sërë aktivitetesh, në funksion të realizimit të kompetencave të saj ligjore. Përkundër faktit se Republika e Maqedonisë së Veriut ka legjislacion të avancuar që rregullon përdorimin e gjuhëve në sektorin publik, një sërë vështirësish dhe sfidash ende shfaqen gjatë zbatimit të tij, gjë që tregon nevojën për angazhim të vazhdueshëm me përpjekje dhe punë të përbashkët për të arritur qëllimet e përcaktuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, përkatësisht avancimin, mbrojtjen dhe zbatimin e

unifikuar të gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuha shqipe).

AZGj-ja do të vazhdojë me zbatimin e aktiviteteve të saj edhe në vitin 2024, sepse angazhimi ynë është që të arrijmë qëllimin e përbashkët për ndërtimin e një shoqërie të qytetarëve të barabartë, duke mundësuar barazi gjuhësore për qytetarët përmes zbatimit të plotë të Rregullores ligjore për përdorimin e gjuhëve.

Në vijim mund të lexoni Raportin, i cili ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha aktiviteteve të ndërmarra në vitin 2023, me rekomandimet përfundimtare për zbatimin më efikas dhe efektiv të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Me respekt,

Ardian Musliu, drejtor

PJESA 1

1.1. Hyrje

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtutjeshëm: AZGj) është themeluar në pajtim me ligjin, në cilësinë e personit juridik, e që është kompetente për standardizimin dhe njësimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Raporti Vjetor i Punës ka të bëjë me periudhën 1.1.2023 deri më 31.12.2023 dhe është përgatitur në bazë të nenit 18, paragrafi (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 7/2019), sipas së cilit AZGJ-ja për punën e saj dorëzon raport te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, së paku një herë në vit, deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Raporti përmban rishikimin e aktiviteteve të AZGJ-së në zbatimin e kompetencave të saj ligjore, me qëllim që të realizohen të drejtat gjuhësore të gjuhëve zyrtare, zbatimi i vazhdueshëm i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përforcimi i kapaciteteve përkthyese të institucioneve etj. AZGJ-ja në punën e saj ishte e vendosur në qëllimin aktiv, që të veprojë në shërbim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës nëpërmjet promovimit të të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përkundër të gjitha përpjekjeve, raportet tona nga terreni, parashtresat e qytetarëve, raportet e medieve dhe të organizatave joqeveritare, tregojnë se shumë qytetarë akoma përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj në komunikimin e përditshëm me institucionet. Kjo tregon se ka nevojë që të gjitha institucionet të japin shumë mund për t’i arritur qëllimet e caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Të udhëhequr nga qëllimi për t’u zgjidhur problemet institucionale lidhur me numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve në institucione dhe cilësinë e dobët të përkthimeve dhe lekturimeve nëpër dokumentet zyrtare, AZGJ-ja ndërmori aktivitete për përforcimin e kapaciteteve të veta për përkthim, duke u furnizuar me softuerin e përkthimit nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas,

me të cilin do të lehtësohet dhe do të zvogëlohet dukshëm koha e nevojshme për përkthimin e dokumentacionit zyrtar.

1.2. Historia e AZGJ-së

Më 6 shkurt 2019 u shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të AZGJ-së, që zgjati deri më 13 shkurt 2019, ku me Aktvendimin e zgjedhjes, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen mbajtur më 25 shkurt 2019, u zgjodh prof. dr. Ylber Sela si drejtor i AZGJ-së.

Më 11 mars 2019 u dorëzua fletëparaqitje për regjistrimin e themelimit të AZGJ-së në Regjistrin Qendror, ku aktvendimi për regjistrimin e themelimit u miratua më 13 mars 2019. Data formale e themelimit të AZGJ-së është 14 janar 2019, respektivisht dita e hyrjes në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.7/2019). Nga themelimi i saj, selia formale e AZGJ-së ishte në bul. "Ilindeni" nr.2/ ndërtesa 6 – zyra 410.

Në mbledhjen e 162-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 5 nëntor 2019, Qeveria e miratoi Vendimin nr. 45-8714/1, për dhënie në shfrytëzim të përhershëm të sendeve të patundshme të AZGJ-së ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 236/2019), që ishte bazë për t'u kryer regjistrimi për ndryshimin e selisë së AZGJ-së, ku me Aktvendim të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120190016864 të datës 21.11.2019, u bë ndryshim i regjistrimit të selisë së AZGJ-së në adresë të re: shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr.4, kati 4, Qendër, Shkup, gjithashtu është regjistruar edhe shkurtesa e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është bërë "Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV".

1.3. Misioni dhe vizioni

AZGJ-ja ka mision të ndërtojë mjedis institucional që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, që e promovon, që e ruan dhe që e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo përfshin aktivitete lidhur me ndihmesën praktike dhe përkrahjen

këshillëdhënëse në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve publike, agjencive, drejtorive, institucioneve dhe organizatave, komisioneve, personave juridikë që kryejnë autorizime publike, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale; kujdes i vazhdueshëm për zbatim të rregullt dhe të qëndrueshëm të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhën shqipe), si dhe avancimin e përdorimit zyrtar të gjuhës, si e drejtë themelore e qytetarëve.

Vizioni i AZGJ-së është të mundësojë barazi gjuhësore të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të rregullores ligjore për përdorimin e gjuhëve. Duke nxitur cilësi të lartë të proceseve të punës, efektivitet të vazhdueshëm dhe efikasitet në punë, të plotësuar me kuadër profesional dhe kapacitete teknike, si dhe të hapur plotësisht për bashkëpunim me publikun, sektorin akademik dhe atë qytetar, AZGJ-ja synon të bëhet e njohur si institucion me rëndësi strategjike në procesin e mbrojtjes, avancimit, standardizimit dhe përdorimin e njësuar të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PJESA 2

2.1. Statusi

AZGj-ja ka cilësinë e personit juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Më 14.1.2019 në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2019 u shpall dhe hyri në fuqi Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, me çka AZGJ-ja u themelua në cilësinë e personit juridik, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të caktuara me të njëjtin ligj.

2.2. Udhëheqja

AZGj-në e udhëheq drejtori i emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar, me të drejtë për t'u rizgjedhur. Për punën e tij dhe për punën e AZGj-së, drejtori i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.3. Kompetencat ligjore të AZGj-së

Në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, AZGj-ja është kompetente për kryerjen e punëve në vijim:

- mbështetjen e institucioneve për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- lekturimin e të gjithë akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut";
- promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- përgatitjen e raporteve për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zbatimin e kompetencave të saj;

- përgatitjen e materialeve profesionale-analitike nga kompetencat e saj për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe

- punë të tjera që lidhen me zbatimin e qëllimeve të vërtetuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Krahas kompetencave të saj ligjore, AZGJ-ja kujdeset për sigurimin e vazhdueshëm të funksionalitetit dhe forcimin e kapaciteteve të veta, si dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, e promovon, e ruan dhe e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.4. Parimet dhe vlerat e punës

- ligjshmëria;

- profesionalizmi dhe kompetenca;

- përfaqësimi i duhur dhe i drejtë;

- shërbimet e orientuara;

- etika profesionale, paanshmëria dhe objektiviteti;

- transparenca dhe besueshmëria;

- përgjegjësia;

- parandalimi i konflikteve të interesit;

- të qenit ekonomik; dhe

- respektimi i standardeve për udhëheqje me cilësi.

PJESA 3

3.1. Vendosja organizative

Duke u nisur nga kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Nëpunësve Administrativë, si dhe nga Dekreti për Parimet e Organizimit të Brendshëm të Organeve të Administratës Shtetërore, e me qëllim të bashkimit të disa funksioneve të ndërlidhura ndërmjet tyre, organizimin, ndjekjen dhe koordinimin me burimet njerëzore, punën profesionalo-analitike, administrative, informativo-komunikuese, operative, materiale, financiare, informatiko-teknologjike, profesionalo-administrative dhe punë të tjera, në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, AZGj-ja është e organizuar në 4 (katër) sektorë me 9 (nëntë) njësi në përbërje të tyre dhe 2 (dy) njësi të pavarura, siç vijon:

(1) Sektori i mbështetjes së drejtorit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Njësia e mbështetjes së drejtorit; dhe
- Njësia e marrëdhënieve me publikun.

(2) Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e avancimit të zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve;
- Njësia e teknologjisë informatike; dhe

(3) Sektori i përkthimit dhe i lekturës, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e përkthimit; dhe
- Njësia e lekturës.

(4) Sektori i punëve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore, me njësitë në vazhdim:


- Njësia e punëve të përgjithshme dhe juridike; dhe

- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Njësitë e pavarura janë:

(1) Njësia e çështjeve financiare; dhe

(2) Njësia e revizionit të brendshëm.



3.2. Burimet njerëzore

Në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në AZGJ janë paraparë 78 vende pune, të cilat i flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga numri i përgjithshëm i vendeve të planifikuara, 75 vende pune kanë statusin e nëpunësit administrativ dhe 3 vende të punës me statusin e asistentit teknik.

Në AZGJ me datë 31.12.2023 janë të punësuar gjithsej 35 persona me statusin e nëpunësit administrative, 1 (një) nëpunësit administrativ i pezullohet marrëdhënia për shkak të emërimit në post publik.

Gjatë vitit 2023, AZGJ-ja ka publikuar 2 shpallje publike për punësimin e 4 (katër) nëpunësve administrativë dhe konkretisht:

- Më datë 24.03.2023 shpallja publike nr. 40/2023 për punësimin e 4 (katër) nëpunësve administrativë nga grupi I, nëngrupi I në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së. Prej tyre janë realizuar 3 (tre) punësime të reja;

- Më datë 05.12.2023, shpallja publike nr. 542/2023 për punësimin e 4 (katër) nëpunësve administrativë nga grupi I, nëngrupi I në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së. Shpallja është në vijim e sipër.

Gjatë vitit 2023, AZGJ ka publikuar 2 shpallje të brendshme për ngritjen në detyrë të 9 (nëntë) nëpunësve administrativë dhe konkretisht:

- Më datë 03.02.2023 u shpall njoftim i brendshëm nr. 01/2023 për avancimin e 6 (gjashtë) nëpunësve administrativë në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së;

- Më datë 19.04.2023, u shpall njoftim i brendshëm nr. 02/2023 për avancimin e 3 (tre) nëpunësve administrativë në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së.

Janë kryer edhe lëvizje të tjera të kuadrit brenda AZGJ-së, që nga data 31.12.2023, nga të cilat:

1. Avancime të realizuara:

- 9 avancime (me shpallje të brendshme);

2. Është realizuar rritje e kuadrit:

- Gjithsej 6

- 3 punësime të reja (me shpallje publike);

- 1 person me procedurë të lëvizshmërisë me marrje nga institucione të tjera;

- 1 person me vendim për zgjedhjen e ushtruesit të detyrës drejtor

- 1 person me vendim për zgjedhjen e drejtorit

3. Reduktimi i realizuar i stafit:

- Gjithsej 6

- 3 persona përmes procedurës së lëvizshmërisë me marrje nga institucione të tjera;

- 1 person me ndërprerje të punës me marrëveshje;

- 1 person me Vendim për skadimin e mandatit;

- 1 person me Vendim për largim nga detyra, ushtrues detyre drejtor

4. Shpërndarjet e realizuara të personelit:

- Gjithsej 3

- 3 persona përmes procedurës së lëvizshmërisë përmes shpërndarjes

Numri i kryerësve të plotësuar:

Këshilltarët shtetërorë –4

Sektori i mbështetjes së drejtorit –6

Sektori i planifikimit, koordinimit dhe zhvillimit –4

Sektori i përkthimit dhe lekturës –12

Sektori i çështjeve juridike, të përgjithshme dhe udhëheqje të burimeve njerëzore –6

Sektori i çështjeve financiare –3

Sektori i revizionit të brendshëm –0

Revizioni i brendshëm –0

Në Njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në bazë të Programit vjetor për trajnime gjenerike të nëpunësve administrativë, të miratuar nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, po përgatitet Plani vjetor për trajnime të nëpunësve administrativë, sipas mendimit të marrë nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës.

Tabela 1. Pasqyra e vendeve të punës të sistemuara dhe të plotësuara në AZGJ

Njësi organizative	Vendet e punës sipas sistematizimit Gjendja më 31.12.2023	Numri i plotësuar i kryerësve Gjendja më 31.12.2023
Këshilltarë shtetëror	4	4
Sektori i mbështetjes së drejtorit	14	7 Një personit i pezullohet marrëdhënia e punës)
Sektori i planifikimit, koordinimit dhe planifikimit	10	4
Sektori i përkthimit dhe lekturimit	25	12
Sektori i çështjeve juridike, të përgjithshme dhe udhëheqje me burimet njerëzore	17	6
Njësia e çështjeve financiare	6	3
Njësia e revizionit të brendshëm	2	0

3.3. Struktura e të punësuarve


Plotësimi sipas kategorive të vendeve të punës të nëpunësve administrativë

- nëpunës udhëheqës administrativë – 13;
- nëpunës profesional administrativë –22;
- nëpunës ndihmës-profesional administrativë – 0;
- persona ndihmës-teknikë – 0.

Plotësimi sipas shkallës së arsimit:

- me arsim të lartë – 35;
- me shkollë të mesme – 0;
- me shkollë fillore – 0.

Grafikoni 1: numri i të punësuarve sipas shkallës së arsimit



Plotësimi sipas strukturës gjinore:

- gjinia femërore – 23
- gjinia mashkullore – 12

Grafikoni 2: Struktura gjinore e të punësuarve





Tabela 2: Struktura e të punësuarve në AZGJ deri më 31.12.2023

Kategoritë e vendeve të punës	Gjinia		Shkalla e arsimit		
	M	F	PLP	PMP	Fillore
Udhëheqëse	6	7	13	0	0
Profesionale	6	16	22	0	0
Ndihmëse-profesionale	0	0	0	0	0
Ndihmëse-teknike	0	0	0	0	0
Gjithsej	12	23	35	0	0

Grafikoni 3. Struktura e të punësuarve në AZGj me gjendjen e datës 31.12.2023



PJESA 4

4.1. Vështrim i punës

AZGJ gjithmonë synon të sigurojë kryerje të sigurt dhe efektive të detyrimeve ligjore që janë kyç, por edhe të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme përforcimin e kapaciteteve të veta.

Prioritetet kryesore dhe qëllimet zhvillimore të AZGJ-së rrjedhin nga kompetencat e saj ligjore dhe fokusohen në zbatimin e plotë dhe të qëndrueshëm të rregullores ligjore për zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, por edhe në rindërtimin dhe përforcimin e saj në aspektin e kapaciteteve për kryerjen e funksioneve të saj. Në këtë kontekst, AZGJ-ja para

vetes ka vendosur shumë qëllime strategjike afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat duhet të realizohen, siç vijon:

- përcjellje e vazhdueshme e implementimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve;
- analizë të përvojave më të mira botërore dhe modeleve të shumëgjuhësisë;
- promovim dhe zhvillim të sistemit për zbatim aktiv të gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- avancim të funksionimit dhe realizimit të kompetencave të AZGJ-së nëpërmjet sigurimit të përkrahjes administrative, logjistike dhe teknike;
- përforcim të kapaciteteve me burime njerëzore nëpërmjet punësimeve të reja, shpërndarjeve dhe avancimeve, në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe kompetencës dhe me zhatimin e parimeve të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive, si dhe nëpërmjet përsosjes profesionale të të punësuarve në AZGJ;
- përforcim të punës financiare dhe materiale, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit strategjik në AZGJ, e plotësuar me aktivitete për themelimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e udhëheqjes financiare dhe kontrollit;
- përmirësim të punës së AZGJ-së nëpërmjet rritjes së efektshmërisë së sistemeve për kontroll të brendshëm dhe përputhshmëria e punës me ligjet, me aktet nënligjore dhe me aktet interne;

- themelim të programeve për të punësuarit në AZGJ për zhvillim sistemor të shkathtësive të tyre, njohurive dhe sjelljes, të nevojshme këto për realizimin e qëllimeve afatmesme dhe afatgjata;
- themelim dhe avancim të bashkëpunimit me palët përkatëse të interesuara, duke përfshirë edhe organet shtetërore, dhomat ekonomike, sektorin joqeveritar, bashkësinë e donatorëve, korin diplomatik, organizatat ndërkombëtare.

4.2. Përkthim dhe lekturim

Gjatë vitit 2023, në AZGJ janë dorëzuar 510 kërkesa për përkthim dhe 256 kërkesa për lekturim të akteve dhe dokumenteve zyrtare.


Numri i kërkesave të arritura për përkthim	Përqindja e përkthimeve të realizuara	Numri i kërkesave të arritura për lekturim	Përqindja e kërkesave të realizuara për lekturim
510	100%	256	100%

4.3. Pyetësorët anketues drejtuar institucioneve të sektorit publik


Gjatë muajit nëntor 2023, në gjithsej 440 institucione të sektorit publik u dërgua pyetësori i pestë, të cilat duhet të përdorin gjuhën e folur nga të paktën 20% të qytetarëve të RMV-së. Nga mesazhet e dërguara, 12 institucione nuk morën një mesazh, për shkak të problemeve teknike me emailin, 87 iu përgjigjën pyetësorit dhe 341 institucione nuk u përpoqën t'i përgjigjen pyetësorit.

Në vijim është dhënë një pasqyrë tabelare e rezultateve të marra në lidhje me çdo pyetje të pyetësorit anketues.

1. A i keni përmbushur detyrimet tuaja sipas Ligjit të përdorimit të gjuhëve dhe nëse nuk i keni përmbushur plotësisht ato në cilën fazë të implementimit jeni?



2. Vallë në aktin tuaj të sistematizimit të vendeve të punës, a keni paraparë formë organizative për përkthim dhe lekturim në dhe nga gjuha shqipe?



3. Sa përkthyes dhe lektorë keni të punësuar në institucionin tuaj?




4. Vallë, në buxhetin e parashikuar për vitin 2024, a keni paraparë mjete financiare për punësimin e përkthyesve dhe lektorëve të rinj?



5. Vallë keni nevojë për ndihmë profesionale nga Agjencia?



6. Vallë deri tani keni kërkuar ndihmë profesionale nga Agjencia?



7. Vallë jeni të kënaqur nga ndihma profesionale nga ana e Agjencisë?



8. Vallë keni kërkuar pëlqim për marrje të përkthyesit nga Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënie me Bashkësitë?



4.4 Regjistri (baza e të dhënave)

AZGJ-ja përgatiti regjistër të personave me status të nëpunësve administrativë, persona të angazhuar në bazë tjetër apo bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilëve u janë dhënë detyra pune për përkthim dhe lekturim, nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas.

Ky regjistër do t'i shërbejë AZGJ-së, që të krijojë një pasqyrë të plotë të gjendjes me kuadrin e përkthyesve dhe të lektorëve në organet e pushtetit qendror, me qëllim që në të ardhmen edhe ata të mund të përfshihen nëpër programet dhe trajnimet për përkthyes dhe lektorë, që do t'i organizojë AZGJ-ja.

4.5. Trajnim për përkthyesit dhe për lektorët e sektorit publik

Gjatë vitit 2023, AZGJ-ja realizoi trajnime për 60 përkthyes dhe lektorë nga institucione të ndryshme, të ndara në 6 grupe, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e kapaciteteve profesionale për përkthim dhe lekturë, si dhe unifikimin e terminologjisë administrative, në bashkëpunim me gjuhëtarët e shquar dhe ekspertët gjuhësorë. Trajnimi filloi në 25 prill dhe zgjati deri më 6 qershor, me pjesëmarrjen e ligjëruesve nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën mundësinë të shtjellojnë një numër problemesh që dalin nga përdorimi i gjuhës shqipe në administratën publike. Problemi me terminologjinë dhe unifikimi i saj si nevojë, ndikimet e gjuhëve, leksikografisë, semantikës, ndikimet sintaksore dhe një numër problemesh të tjera ishin objekt i përpunimit nga profesorët Emil Lafe, Valter Memisha, Rami Mamushaj, Xhevat Lloshi, Dorian Koçi, Manjola Lumani, Olger Brame, Asllan Hamiti, Ismet Osmani, Zeqirja Ibrahimi, Berton Sulejmani, Bashkim Selmani, Adnan Jashari, Afet Mamuti, Mustafa Ibrahimi, Ajten Hajdari-Qamili, Arta Selmani, Arsim Jonuzi dhe Ali Pajaziti.

Projekti i trajnimit i organizuar nga AZGJ-ja ishte i treti me radhë dhe do të vazhdojë vitin e ardhshëm me të njëjtin intensitet dhe përkushtim profesional.



Me mbështetjen financiare dhe teknike të Misionit të OSBE -së në Shkup në 2021, u përgatit një udhëzues për trajnimin e përkthyesve dhe lektorëve, në 3 (tri) gjuhë, dhe i njëjti iu shpërnda secilit prej pjesëmarrësve të trajnimit.



Më 8 qershor 2023, AZGJ-ja organizoi një ceremoni përmbyllëse me certifikata për të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit. Më shumë informacione lidhur me trajnimin, mund të lexoni në Pjesën 6 të raportit.

4.6. Parashtresat e pranuara

Në vitin 2023, në AZGJ u dorëzuan 5 (pesë) parashtresa, ku në bazë të përmbajtjes së tyre, u vërtetua nëse ajo është në kompetencë të AZGJ-së. Parashtruesi merr përgjigje profesionale në kohë, e nëse parashtresa nuk është në kompetencë të AZGJ-së, ajo përcjellet tek organi kompetent, ku informohet edhe dorëzuesi i parashtresës se te cili organ është dërguar për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe për të vepruar sipas saj.

Parashtresat kanë të bëjnë me çështje që lidhen me që lidhen me kufizimet në zbatimin e gjuhës zyrtare të folur nga të paktën 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë Veriore (gjuha shqipe) në lëmi të ndara.

4.7. Informimi

AZGJ-ja në mënyrë të vazhdueshme ka punuar për ngritjen e vetëdijes së popullatës dhe të institucioneve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjuhësore. Komunikimi u realizua në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qytetarët, me sektorin joqeveritar dhe me përfaqësuesit e institucioneve, nëpërmjet formave të ndryshme, si mbledhje, takime pune, takime në terren dhe në forma të tjera të komunikimit.

4.8. Buletini periodik

AZGJ-ja në nivel mujor përgatit buletinin mujor për aktivitetet, me qëllim që të përmirësohet transparenca në punë.

Buletini çdo muaj shpallet në ueb faqen zyrtare të AZGJ-së, në gjuhën maqedonase, atë shqipe dhe në atë angleze dhe përmban pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve mujore që janë realizuar.

Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

BULETIN MAJ – QERSHOR 2022



Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Më 10 maj, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGj), Ylber Sela i shoqëruar nga ekipi i tij, vizitoi Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ku u prit nga rektori i këtij universiteti, Skender Topi, zëvendësrektorja për kërkimin shkencor, Elvira Fetahu, zëvendësdekania e Fakultetit të Shkencave Humane, Aurela Basha, si dhe pedagogia e gjuhës, Teuta Toska.



Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës ligjëroi profesoresha e gjuhës shqipe, Albulena Dehari

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) priti sot gjuhëtaren Albulena Dehari, ligjëruese në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës. Ajo pati rastin që të njihet më hollësisht me veprimtarinë e deritashme të AZGj-së, si dhe me planet për të ardhmen. Me këtë rast, Dehari mbajti një ligjëratë para përkthyesve dhe lektorëve të Agjencisë me temë "Përshtatja e gjymtyrëve në fjali".



Mbaroi java e tetë e trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka vazhduar trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të gjuhës shqipe në institucionet publike.

Gjatë javës së tetë u realizua trajnimi në dy tema të ndryshme. Për temën e parë, "Titrat", ligjëroi Olger Brame, ndërkaq për temën e dytë, "Çështje drejtshkrimore dhe të pastërtisë së gjuhës", ligjëroi Emil Lafe. Përkthyesit dhe lektorët kishin mundësinë që të qartësojnë dilemat e tyre që hasin në temat e lartpërmendura gjatë punës së përditshme të tyre.

Република Северна Македонија

Агенција за примена на јазикот на РСМ

БИЛТЕН АПРИЛ 2022



АПЈ и Мисијата на ОБСЕ во Скопје ќе реализираат обука за симултан превод

Директорот на АПЈ, Илбер Села, оствари работна средба со претставници од Мисијата на ОБСЕ во Скопје предводена од Катарина Живковиќ, програмски асистент во Мисијата.

Тема на дискусија беше продолжување на одличната соработка меѓу двете институции и спроведување нова заедничка активност што се планира да се реализира во текот на месец мај.



Промовирана научната публикација „Правни аспекти на употребата на јазиците во Република Северна Македонија"

Вчера, во амфитеатарот на Универзитетот на Југоисточна Европа во Скопје, беше промовирана научната публикација „Правни аспекти на употребата на јазиците во Република Северна Македонија" на авторите проф. д-р Илбер Села и м-р Лазо Матовски. Промоцијата на научната публикација беше организирана од страна на Агенцијата за примена на јазикот на РСМ, во соработка со Правниот факултет на Универзитетот на Југоисточна Европа и Правниот факултет на Универзитетот од Тетово.

Republic of North Macedonia

Language Implementation Agency of RNM

NEWSLETTER MAY – JUNE 2022



Cooperation agreement with the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

On May 10, the director of the Language Implementation Agency (LIA), Ylber Sela, accompanied by his team, visited the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani" where he was received by the Rector of this university, Skender Topi, the Deputy Rector for scientific research, Elvira Fetahu, Deputy Dean of the Faculty of Humanities, Aurela Basha, as well as the Head of the Department of Languages, Teuta Toska.



Albanian language professor Albulena Dehari lectured at the Language Implementation Agency

The Language Implementation Agency (LIA) received today the linguist Albulena Dehari, lecturer at the Faculty of Philology of the University of Tetova. She had the opportunity to get acquainted in more detail with the current activities of LIA, as well as with the plans for the future. On this occasion, Dehari gave a lecture to the translators and lecturers of the Agency on "Adaptation of the parts of sentence."



The eighth week of training of translators and proofreaders is over

The training of Albanian language translators and proofreaders of the public institutions has continued at the Language Implementation Agency (LIA). During the eighth week, training was conducted on two different topics. Olger Brame lectured on the first topic, "Titrat", while Emil Lafe lectured on the second topic, "Çështje drejtshkrimore dhe të pastërtisë së gjuhës". Translators and proofreaders had the opportunity to clarify their dilemmas encountered in the above-mentioned topics during their daily work.

ПИОСМ ја потврдија меѓуинституционалната соработка


ректор на Агенцијата за примена на јазикот (АПЈ), Илбер Села, ојуван од неговиот тим, беше во работна посета во Фондот за ско и инвалидско осигурување, каде што беше примен од ректор на оваа институција, Дритан Беџети, заменик-директорот ствнели и нивниот тим.

а пригода беше потврдена блиската меѓуинституционална ка поврзана со спроведувањето на Законот за употреба на к.

4.9. Ueb faqja zyrtare dhe mediet digjitale

Ueb faqja zyrtare e AZGJ-së - www.apj.gov.mk, vazhdimisht përditësohet me përmbajtje informative në 3 (tri) gjuhë, lidhur me aktivitetet e AZGJ-së, me qëllim që të ruhet parimi i transparencës dhe mundësisë së AZGJ-së për qasje te publiku më i gjerë.

AZGJ-ja shpërndan aktivitetet lidhur me punën e saj edhe në rrjetet sociale Facebook dhe në Youtube.



4.10 Fjalori elektronik VERBIS

Në kuadër të AZGJ-së, funksionon fjalori elektronik interpretues kontekstual VERBIS, në formë të fjalorit përshkrues dygjuhësh, në maqedonisht dhe në shqip. Në të shpjegohen në mënyrë leksikografike fondet më të përdorura të fjalëve në të dy gjuhët.

Fjalori përmban module në fushën e terminologjisë administrative-juridike, ekonomike dhe financiare, shëndetësore dhe të përgjithshme.

Moduli nga lëmia administrative-juridike, përmban mbi 10.000 fjalë dhe janë përgatitur gjithashtu fonde fjalësh për modulin e fushës shëndetësore dhe për terminologjinë ekonomike dhe financiare. Fjalori dhurohet në www.verbis.gov.mk.



4.11. Publikime të shtypura dhe elektronike



4.12 Aktet e nënshkruara të bashkëpunimit

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, përveç akteve të përfunduara tashmë për bashkëpunim në vitin 2019, në vitin 2020, në vitin 2021 dhe 2022, zyrtarizoi bashkëpunimin me njësi të reja institucionale nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, duke nënshkruar një akt shtesë të bashkëpunimit në vitin 2023.

Më poshtë është një orar kronologjik i vazhdimit të aktiviteteve nga aktet e nënshkruara të bashkëpunimit, në vitet e kaluara, si dhe aktet e nënshkruara të bashkëpunimit në vitin 2023.

23 maj 2023 – Qendra Europiane e Gjuhëve Moderne dhe AZGJ-ja avancojnë bashkëpunimin



26 shtator 2023 – Vazhdon bashkëpunimi mes AZGJ-së dhe UT-së





25 tetor 2023 – Është nënshkruar Memorandum për bashkëpunim mes Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Zyrës së Gjuhëve të Kosovës



4.13 Pasqyrë e akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" në vitin 2023

Në pajtim me nenin 17, paragrafi (1) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.7/2019), të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e institucioneve sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të këtij ligji, që shpallen në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", shpallen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

AZGJ-ja përgatiti pasqyrë statistikore të të gjitha akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", që përbëhet nga institucionet sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Në bazë të pasqyrës së përgatitur, është konstatuar përqindja e përputhshmërisë së institucioneve sa i takon implementimit të detyrimit sipas nenit 17 të ligjit.

Nr. rendor	EMRI I INSTITUCIONIT	Gjithsej botime të shpallura	Botime të shpallura vetëm në gjuhën maqedonase	Botime të shpallura në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj	**Përqindja e pëlqimit me detyrimin sipas nenit 17 të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (%)**
1	QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	221	221	0	0,00%
2	KRYETARI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	28	28	0	0,00%

3	KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	51	0	51	100,00%
4	MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE	26	11	15	57,69%
5	MINISTRIA E FINANCAVE	13	1	12	92.31%
6	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	19	19	0	0,00%
7	MINISTRIA E DREJTËSISË	25	3	22	88.00%

8	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE E EKONOMISË SË UJËRAVE	20	19	1	5,00%
9	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	5	0	5	100%
10	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	13	13	0	0,00%
11	MINISTRIA E EKONOMISË	11	4	7	63,64%
12	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS	10	1	9	90,00%
13	MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E LIDHJEVE	10	10	0	0,00%
14	MINISTRIA E MBROJTJES	3	3	0	0,00%
15	MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	12	5	7	58,33%
16	MINISTRIA E KULTURËS	1	1	0	0,00%
17	MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE E ADMINISTRATËS	3	1	2	66,67%
18	BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	23	1	22	95,65

19	GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	35	35	0	0,00%
20	KËSHILLI I PROKURORËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	13	13	0	0,00%
21	PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË S VERIUT	1	1	0	0,00%
22	KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	45	0	45	100,00%
23	AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	0	1	100,00%
24	AKADEMIA E TRAJNIMIT TË GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIK “PAVEL SHATEV”	5	5	0	0,00%
25	AGJENCIA E USHQIMIT DHE E VETERINARISË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	51	51	0	0,00%
26	AGJENCIA E TË RINJVE DHE E SPORTIT	3	3	0	0,00%
27	AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE, AUDIO DHE AUDIOVIZUALE	12	0	12	100,00%
28	AGJENCIA E KADASTRËS SË PATUNDSHMËRIVE	6	6	0	0,00%
29	AGJENCIA E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	6	3	3	50,00%
30	AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË	4	0	4	100,00%

	SIGURIMIT PENSIONAL TË FINANCIMIT KAPITAL				
31	AGJENCIA E BARNAVE DHE E MJETEVE MEDICINALE	1	0	1	100,00%
32	AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË SIGURIMIT	10	3	7	70,00%
33	AGJENCIA E POSTAVE	2	1	1	50,00%
34	AGJENCIA E UDHËHEQJES SË PASURISË SË KONFISKUAR	1	1	0	0,00%
35	AGJENCIA E FLUTURIMEVE CIVILE	3	3	0	0,00%
36	ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS	10	0	10	100,00%
37	KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE	4	0	4	100,00%
38	KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT	3	3	0	0,00%
39	INSPEKTORATI SHTETËROR I VETËQEVERISJES LOKALE	3	3	0	0,00%
40	KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	162	0	162	100,00%
41	KOMISIONI LIGJVËNËS-JURIDIK I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	2	0	2	100,00%

42	KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	33	0	33	100,00%
43	FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR	11	0	11	100,00%
44	FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR	3	1	2	66,67%
45	KËSHILLI NACIONAL I ARSIMIT TË LARTË DHE VEPRIMTARISË HULUMTUESE SHKENCORE	5	3	2	40,00%
46	DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË ZONAVE TEKNOLOGJIKE INDUSTRIALE	5	5	0	0,00%
47	DREJTORIA E SIGURISË SË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA	1	1	0	0,00%
48	DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	1	1	0	0,00%
49	INSTITUTI I NDËRTESAVE REZISTUESE SIZMIKE DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	1	1	0	0,00%
50	INSTITUTI I INXHINIERISE TE TERMETEVE DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE SHKUP IITNK	1	1	0	0,00%
51	ADMINISTRIMI I FARAVE DHE MATERIALIT BIMOR	4	4	0	0,00%
52	ODA E NOTERËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	4	1	3	75,00%

53	ODA E PËRMBARUESVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	14	14	0	0,00%
54	ODA E AVOKATISË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	3	3	0	0,00%
55	ODA DENTALE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	1	0	0,00%
56	ODA E ARKITEKTËVE TË AUTORIZUAR DHE INXHINIERËVE TË AUTORIZUAR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	1	1	0	0,00 %
57	SHA E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE MENAXHIMI ME SISTEMIN ELEKTROTRANSMETUES MEPSO	2	2	0	0,00%
58	OPERATORI KOMBËTAR I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE-MEMO SHPKNJP SHKUP	1	1	0	0,00%
59	NOMAGAS SHA SHKUP	2	2	0	0,00%
60	UNIONI I SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE TË MAQEDONISË	3	3	0	0,00%
61	PUSHTETI VENDOR	17	15	2	11,76%

PJESA 5

5.1. Buxheti, llogaria përfundimtare dhe financimi

AZGJ si organ i pavarur shtetëror është përfitues buxhetor.


Në vitin 2023, buxheti i përgjithshëm i miratuar vjetor i AZGJ arriti në 49.454.000,00 denarë. Me ribalancin e buxhetit për vitin 2023, buxheti i përgjithshëm i AZGJ-së është zvogëluar dhe arrin në 40.743.000,00 denarë.

Tabela 5. Struktura e Buxhetit të AZGJ-së për vitin 2023

Zëri	Përshkrimi	BUXHETI PËR VITIN 2023 (në kundërvlerë të denarit)					REBALANCI I BUXHETIT PËR VITIN 2023
		Buxheti (630)	Shpenzime nga të ardhurat prej organeve (631)	Shpenzime nga aktivetet vetëfinancuese (787/788)	Shpenzime nga donacione (785)	Gjithsej shpenzime	Gjithsej shpenzime
40	Rroga dhe kompenzime	21.300.000,00	/	/	/		21.300.000,00
401	Rrogat bazë	15.550.000,00	/	/	/		15.200.000,00
402	Kontribute për sigurim social	5.750.000,00	/	/	/		5.750.000,00
404	Kompenzime	0,00	/	/	/		350.000,00
42	Mallra dhe shërbime	18.065.000,00	/	/	/		15.714.500,00
420	Shpenzime rrugore dhe ditore	1.000,00	/	/	/		499.500,00

421	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	2.355.000,00	/	/	/		2.355.000,00
423	Materiale dhe inventar i imët	300.000,00	/	/	/		300.000,00
424	Përmirësime dhe mirëmbajtje vijuese	1.500.000,00	/	/	/		1.500.000,00
425	Shërbime kontraktuese	12.000.000,00	/	/	/		10.150.000.00
426	Shpenzime të tjera vijuese	910.000,00	/	/	/		900.000,00
464	Transfere të ndryshme	0	/	/	/		10.000,00
48	Shpenzime kapitale	3.935.000,00	/	/	/		3.728.500,00
480	Blerje të pajisjeve dhe makinave	1.327.000,00	/	/	/		1.778.600,00
481	Objekte ndërtimore	350.000,00	/	/	/		143.500,00
483	Blerje të mobiljeve	0,00	/	/	/		0,00
485	Investim dhe mjete jofinansiare	2.258.000,00	/	/			1.806.400,00
486	Blerje e automjeteve	0,00	/	/	/		0,00

Grafiku 3. Buxheti i AZGJ-së në vitin 2023



5.2. Furnizimet publike

1. Numri i vendimeve të miratuara për prokurim publik: 15
2. Numri i shpalljeve të publikuara për prokurim publik të ESJN: 15
3. Numri i procedurave të nisura të negociatave pa shpallje paraprake: 0
4. Numri i vendimeve të marra për zgjedhjen e ofertës më të favorshme: 14
5. Numri i procedurave të anuluara: 1
6. Numri i kontratave të prokurimit publik të lidhur: 14
7. Vlera e kontratave të lidhura:

   3.348.270,00 denarë (pa TVSH)

   3.719.603,00 denarë (me TVSH)

Vendimet e miratuara për furnizime publike	Shpalljet e publikuara të ESJN	Procedurat e filluara me bisedim pa publikim paraprak të shpalljes	Vendimet e miratuara për zgjedhje të ofertës më të volitshme	Vendimet e miratuara për anulim të procedures	Marrëveshjet e nënshkruara për furnizime publike	Vlera e marrëveshjeve të nënshkruara (pa TVSH)
15	15	0	14	1	14	3.348.960,00 DMK

PJESA 6

6.1. Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara

Në vitin 2023, AZGJ ka bashkëpunuar me një numër të madh institucionesh dhe organizatash përmes realizimit të takimeve të punës, eventeve, konferencave, seminareve, trajnimeve, takimeve online, megjithëse ka punuar në kushte të kufizimeve buxhetore dhe masave në lidhje me përdorimin e fondeve për zbatimin e aktiviteteve zyrtare.

Në vazhdim të Raportit jepet një përmbledhje e ngjarjeve, takimeve dhe aktiviteteve të realizuara në vitin 2023.

22 shkurt 2023

Fjalimi i prof. dr. Ylber Sela, Shkup

Para plot katër viteve, në konkursin e rregullt, sipas nenit 18 të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, u zgjodha drejtor i parë i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës. Gjatë këtyre viteve kishim një veprimtari të dendur të kësaj Agjencie. Këtë javë zhvilluam aktivitetet përmbyllëse të punës katërvjeçare gjatë mandatit të parë. Promovuam botimet e fundit, si dhe raportin përmbledhës të punës për këto vite. Nuk thonë kot se koha po ik shumë shpejt. Katër vite më parë, me shumë entuziazëm, pranova detyrën e udhëheqjes së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës. Si çdo fillim, edhe kjo punë nuk ishte e lehtë. Jo vetëm për mua si drejtor, por i tërë ekipi themelues dhe së bashku me bashkëpunëtorët e parë, u ballafaquam me vështirësi të ndryshme. Ne jemi munduar që të kultivojmë një bashkëpunim me akademitë, institutet, qendrat albanologjike dhe universitetet e shteteve tona. Kemi pasur nevojë për përkrahje, për këshillën e tyre shkencore, që në fazat e para të themelimit të Agjencisë, si dhe gjatë tërë veprimtarisë së saj ndër vite.

Agjencia, krahas përmbushjes së detyrave të përditshme, ka nxitur dhe mbështetur në vazhdimësi fushatën e ngritjes së vetëdijes publike për zbatimin e

Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Për këtë arsye ka zhvilluar pa reshtur, takime pune me çdo institucion shtetëror të vendit, për të ofruar ndihmën në procesin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës. Organizuam trajnime, sivjet të tretin me radhë, për përkthyesit dhe redaktorët gjuhësorë të institucioneve shtetërore në vend. Mësimdhënës në këto trajnime, janë profesorë eminentë nga universitetet, institutet, qendrat albanologjike nga Tirana, Shkodra, Elbasani, Durrësi, Korça, Prishtina, Prizreni, Shkupi, Tetova, pa kontributin e të cilëve, nuk do të kishte këtë sukses dhe cilësi, i gjithë procesi i trajnimeve.

Ndër vite botuam broshura informuese, udhëzime, doracakë, në tri gjuhë, për çështje të statusit të gjuhës, politikës gjuhësore, shumëgjuhësisë dhe sfida të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës. Me pjesëmarrje të studiuesve, profesorëve, albanologëve të shquar, nga të gjithë trevat shqiptare, organizuam për çdo vit, nga një konferencë ndërkombëtare, edhe me studiues të huaj, ku u trajtuan tema të ndryshme të shumëgjuhësisë dhe të politikës gjuhësore, në dobi të njohjes më të mirë të këtyre çështjeve dhe të përshpejtimit të zbatimit zyrtar të dygjuhësisë në vend. U botuan, si libra më vete, kumtesat e këtyre konferencave, në tri gjuhë, në version të shtypur dhe elektronik. Këto u shpërndanë falas për nëpunësit shtetërorë, administratën dhe bashkëpunëtorët tanë, pjesëmarrës direkt në këtë proces të zbatimit të ligjit.

Zhvilluam vizita pune dhe qëndrime studimore edhe jashtë vendit, në Itali, Tirolin e Jugut, në Austri, në Zvicër, për të mësuar më shumë për modelet e suksesshme të dy dhe shumëgjuhësisë në shtetet demokratike të Europës Perëndimore. Mësojmë përherë prej tyre, kultivojmë bashkëpunimin me institucionet përkatëse të atyre vendeve, për të lehtësuar njohjen e këtyre çështjeve, dhe për të përshpejtuar procesin e zbatimit të ligjit në fjalë.
Zhvilluam anketime, intervista, tryeza shkencore, bëmë vetë kërkime dhe botuam studime për situatën dhe politikën gjuhësore, shumëgjuhësinë dhe çështje të tjera që ndërlidhen me këtë tematikë. Të gjithë këta botime, jemi munduar të jenë në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe anglisht, në version të shtypur dhe digjital, për të pasur qasje, çdo bashkëpunëtor i yni, dhe secili që ka interes dhe merret me këtë problematikë.

Aktivitetet e kësaj jave të fundit si drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, i përmbyllëm me organizimin e tryezës së rrumbullakët, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, me temat bosht: “Gjuha shqipe dhe sfidat aktuale të saj” dhe “Gjuha standarde shqipe dhe sfidat e përdorimit zyrtar të saj”.

Pjesëmarrës në këtë tryezë shkencore ishin udhëheqësit e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, si dhe emra të njohur nga kryeqendrat e albanologjisë, Tirana, Prishtina dhe Shkupi, pjesëmarrje kjo e vazhdueshme, që nga themelimi i Agjencisë. U lexuan kumtesa, si dhe u diskutua gjerë e gjatë për temën në fjalë, për sfidat e sotme të mbarë shqipes, me vështrim të veçantë u debatua, për statusin dhe sfidat e zbatimit zyrtar të shqipes në RMV.

Për në të ardhmen mbetet detyrë, jo vetëm e Agjencisë, por e çdo institucioni shtetëror, e secilit individi me vete, që të përkujdesen për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, për arritjen e barazisë gjuhësore në vend, për përshpejtim të përdorimit zyrtar të dygjuhësisë, si dhe për kultivimin e vlerave të shumëgjuhësisë.

Edhe njëherë dua të falënderoj të gjithë përkrahësit dhe bashkëpunëtorët e Agjencisë për punën e palodhshme, me përkushtim të dalluar dhe kontributin që kanë dhënë ndër vite.

Falënderim të përzemërt vëllazëror kam pasur përgjithmonë për këshillat, ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme të studiuesve, profesorëve, albanologëve nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, diaspora jonë, si dhe kuptohet, nga vendi ynë.

Uroj që edhe në të ardhmen, të kemi një vazhdimësi të sigurt të punës së suksesshme të Agjencisë. Drejtorit të ardhshëm dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të Agjencisë ju uroj punë të mbarë dhe suksese të vazhdueshme.



23 shkurt 2023

Dorëzim i Raportit Vjetor të Punës së AZGJ-së

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve (AZGJ), Ylber Sela, ka zhvilluar një takim pune me Fatmir Isenin, drejtor i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve (IPGJ).
Me këtë rast, drejtorët diskutuan për funksionimin katërvjeçar të AZGj-së. Në të njëjtën kohë, Sela ka dorëzuar raportin e shtypur për punën e mëparshme në Inspektoratin e përdorimit të gjuhëve.

Takime të ngjashme janë mbajtur edhe me Admir Ujkanoviq, drejtor i Administratës për Kulturë në Komunitete, si dhe me Eran Kurtish, drejtor i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Komuniteteve.

Kolegët e pranuan raportin e punës, gjatë të cilit u diskutua për punën e mëparshme të institucioneve përkatëse.



23 shkurt 2023

Projekti ndërkombëtar i miratuar i AZGJ-së

Në kuadër të angazhimeve për afirmimin ndërkombëtar dhe vlefshmërinë e punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, në nëntor të vitit 2022, Agjencia përgatiti një projekt që u aplikua në Qendrën Europiane për gjuhët moderne (ESML) në Grac, Austri, e cila është pjesë e Këshillit të Europës me seli në Strasburg, Francë, pas një thirrjeje ndërkombëtare të shpallur më parë.

Pas vlerësimit të projektit, më 20 shkurt të vitit 2023, AZGJ-ja mori njoftim zyrtar se po i njëjti ishte miratuar.

Projekti i referohet mbështetjes në trajnim dhe ndihmës së ekspertëve brenda modulit të Edukimit shumëgjuhësh dhe do t'i përfshijë të punësuarit e AZGJ-së, të cilët do të kenë mundësinë të përmirësojnë aftësitë e tyre për të punuar në një mjedis shumëgjuhësh. Emri i plotë i modulit brenda të cilit do të zbatohet projekti Arsimi plurilingual – Qasje pluraliste ndaj gjuhëve dhe kulturave. Një vegël didaktike për arsimin e integruar plurilingual dhe ndërkulturor – FREPA (Plurilingual education – Pluralistic approaches to languages and cultures. A didactic tool for integrated plurilingual and intercultural education (FREPA)).

Gjatë muajit maj të vitit 2023, dr. Andrea Young, profesor i rregullt në Fakultetin e Arsimit dhe të Mësimit të Përhershëm në Universitetin e Strasburgut, do të qëndrojë në selinë e AZGJ-së në Shkup, i cili do të jetë ekspert i projektit i punësuar nga grantdhënësi, në bashkëpunim me koordinatorin e modulit profesor Michel Candelier, ndërsa nga ana e AZGJ-së është përgatitur dhe me atë aplikoi Llazo Matovski nga ekipi i AZGJ-së.

Realizimi i projektit vërteton bashkëpunimin e suksesshëm të AZGJ-së me Qendrën Europiane për gjuhët moderne, i cili u krijua me vizitën e qendrës nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, në muajin maj të vitit 2022.


EUROPEAN CENTRE FOR
MODERN LANGUAGES
E C M L
C E L V
CENTRE EUROPEEN POUR
LES LANGUES VIVANTES


COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

24 shkurt 2023

Informacion nga zv.drejtori Izmit Nura se emri i Agjencisë për Emigracion në shqip nga sot do të jetë Agjencia e Mërgatës, përkthim zyrtar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së.

Zëvendësdrejtori Izmit Nura është shembull i aplikimit të gjuhës shqipe në institucionet që ai ka drejtuar dhe nuk ka munguar asnjëherë në bashkëpunimin me agjencinë tonë.

Ruajtja dhe edukimi i gjuhës shqipe brenda dhe jashtë vendit është misioni që na bashkon.



24 shkurt 2023

Takimi i fundit i z.Ylber Sela si drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve (AZGJ)

Raporti katërvjeçar për punën e z. Ylber Sela, drejtor i AZGJ-së, është dorëzuar te kryetari i Kuvendit, z. Talat Xhaferi.



1 prill 2023

Intervistë e z. Ardian Musliu, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, për TVM2







3 prill 2023

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dërgoi për përkthim dhe redaktim në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Dekretin për përdorimin e uniformave dhe emblemave të Policisë së Shtetit.

5 prill 2023

Drejtori Musliu u takua me kryetarin e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve të Malit të Zi, z. Faik Nika

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, drejtori Ardian Musliu u takua me kryetarin e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve të Malit të Zi, z. Faik Nika, i shoqëruar nga gjuhëtari, prof. Dr. Haxhi Shabani nga Ulqini dhe anëtar i Komisionit për Arsim të Këshillit.

Në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin institucional mes shqiptarëve nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Me këtë rast, drejtori i AZGJ-së, Ardian Musliu, u uroi mirëseardhje të ftuarve dhe i njoftoi për punën që Agjencia po bën në lidhje me aplikimin e gjuhës në nivel profesional, me historikun e saj, si dhe me sektorët që punojnë në Agjenci.

Të ftuarit shprehën mirënjohjen për mikpritjen dhe përgëzuan drejtorin Musliu për punën që po bën, duke theksuar se aktiviteti i Agjencisë është shumë i rëndësishëm në drejtim të zbatimit të dygjuhësisë në nivel shtetëror dhe se një institucion i tillë do të ishte një model i mirë që mund të aplikohet edhe në Mal të Zi.

Të dyja palët ranë dakord se takimi është një hap i mirë që do të sjellë bashkëpunim konkret në të ardhmen.



14 prill 2023

Drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, takoi përfaqësues të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës

Drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, i priti në agjenci përfaqësuesit e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës (MShIA), Laura Ajdini dhe Gent Salihin, me ç'rast u diskutua për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ministria.

Drejtori Musliu shfaqi gatishmërinë e tij për ta ndihmuar MShIA-në në përkthimin e disa materialeve të caktuara në pjesën legjislative, ndër to edhe pyetësorin për udhëheqës administrativë.

Të dyja palët konfirmuan bashkëpunimin e mirë ndërinstitucional që ka qenë deri më tani, duke shpresuar në mbarëvajtje të punës mes dy institucioneve.



25 prill 2023

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së e filloi sot trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të sektorit publik

Gjashtëdhjetë punonjës në institucione të ndryshme dhe administratës të Maqedonisë së Veriut, do të fillojnë sot, në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup, trajnimin për përkthim dhe lekturim në nivelin më të lartë të profesionalizmit të gjuhës shqipe.

Ky është viti i tretë që Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, i zhvillon trajnimet e kuadrove të përkthimit dhe i pari i këtij lloji në vendet e rajonit.

Duke vërejtur se ka një sërë problemesh në përdorimin e gjuhës, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, nëpërmjet këtij trajnimi, ka si qëllim t'i trajnojë përkthyesit dhe lektorët e të gjitha institucioneve, së pari të ministrive, organeve shtetërore, gjykatave dhe gjithë sektorit publik, për përkthimin sa më të drejtë të gjuhës.

Gjatë trajnimit do të ligjërojnë profesionistë të njohur të gjuhës, juristë dhe njohës të fushave të ndryshme nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria. Kjo nënkupton unifikimin e terminologjisë profesionale në gjuhët, që përdoren në vend dhe ngritjen e cilësisë së përdorimit të tyre, si edhe kthimin e dinjitetit të punës së përkthyesve, pse jo edhe licencimin tyre në gjuhën shqipe, në të njëjtën mënyrë siç është i rregulluar statusi i lektorëve të gjuhës maqedonase.

Koordinatorja e trajnimit, prof. Shpresa Zeqiri Ibrahimi, na sqaroi se: "Duke parë përvojat e përkthyesve, lektorëve apo hartuesve të shkresave administrative, në temat që do të trajtohen për këtë vit, kemi përfshirë të gjitha rrafshet, si analiza e tekstit, përkthimi i teksteve të veçanta socialo-kulturore, furnizimin me fjalë dhe shprehje të softuerit, etj. në shumicën e institucioneve shtetërore", vazhdon prof. Shpresa Zeqiri Ibrahimi, "nuk ka shumë përkthyes nga shqipja në maqedonisht dhe anasjelltas, as lektorë, por edhe aty ku ka, jo të gjithë janë të profilizuar mirë. Për këtë arsye e kemi organizuar trajnimin e tyre të klasifikuar në grupe të përkthyesve dhe lektorëve".

Drejtori i Agjencisë së Gjuhëve, Ardian Musliu, i përshëndeti sot përkthyesit, lektorët dhe profesorët titullarë që do të marrin pjesë në trajnimin e organizuar nga Agjencia. Ai gjithashtu theksoi: "Njëra nga detyrat e AZGj-së është trajnimi i

përkthyesve dhe lektorëve i të gjitha institucioneve të vendit, duke bërë që politikat gjuhësore të gjejnë zbatim dhe të unifikohet terminologjia administrative. Të shkruarit dhe përkthimi janë veprime të ndërlikuara, që kërkojnë përgatitje të lartë profesionale dhe përvojë të madhe. Zyrtarizmi i gjuhës shqipe në nivel shtetëror është një hap me peshë të madhe politike në vendin tonë".

Trajnimi i përkthyesve dhe lektorëve do të zgjasë 6 javë, nga dy here në javë, dhe do të mbahet në auditorët e AZGj-së.

Në vazhdimësi ne do t'ju njoftojmë çdo javë për temat dhe emrat e profesorëve që do të ligjërojnë. Këtë javë do të ligjerojnë profesoresha Ajtene Hajdari Qamili dhe profesori Mustafa Ibrahimi.



4 maj 2023

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës vazhdon trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të sektorit publik

Sot në auditorët e AZGj-së vazhdon trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve me këto tema: "Përkthimi i teksteve letrare", me ligjërues Prof. dr. Berton Sulejmanin dhe "Terminologjia", me ligjërues Prof. dr. Ismet Osmanin.

Ashtu siç kemi njoftuar edhe më parë, trajnimi për përkthim dhe lekturim të gjuhës shqipe, përfshin përkthyesit dhe lektorët nga të gjitha institucionet; ministritë, ndërmarrjet publike, gjykatat dhe tërë sektori publik.

Edhe në javën e dytë të trajnimit, kandidatët të ndarë në katër grupe, me ç'rast kanë mundësinë të pajisen me njohuri të reja nga profesorët e njohur të gjuhës, ku do t'i lartësojnë njohurit e tyre në gjuhën shqipe.

Njësimi i terminologjisë profesionale në gjuhët shqipe, si edhe ngritja e cilësisë së përdorimit të saj, është njëri nga qëllimet e trajnimit, temë e cila do të trajtohet pikërisht gjatë kësaj jave, për t'u zbatuar në praktikën institucionale. Ndërsa tema e përkthimeve letrare ka të bëjë, me përkthimin dhe lekturimin e teksteve të veçanta nga aspekti kulturor në përgjithësi.

Në fund të gjashtë javëve të trajnimit kuadrot do të pajisen me certifikatë, që do ta profesionalizojnë statusin e tyre si përkthyes dhe lektorë, me qëllim të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



9 maj 2023

Vazhdon java e tretë e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës së RMV-së

"Shkrimi ligjor, formularët dhe kërkesat"; "Aspektet juridike e kushtetuese të ligjit" janë dy temat që po trajtohen këtë javë në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të sektorit publik të organizuar nga AZGj-ja, të cilat do t'i ligjërojnë Prof. dr. Bashkim Selmani dhe Prof. dr.Jeton Shasivari.

Vetë përzgjedhja e temave dhe ndërlikueshmëria e të qenët përkthyes dhe lektor profesionist, flet shumë për qasjen serioze të AZGj-së, për të trajnuar lektorët e përkthyesit e institucioneve të sektorit publik, duke pasur parasysh problematikat e zbatimit të dygjuhësisë në përditshmëri.

Koordinatorja e projektit Prof. Shpresa Zeqiri Ibrahimi, në lidhje me temat ka sqaruar se: "Temat janë përzgjedhur me shumë kujdes, duke pasur parasysh edhe trajnimet e mëhershme, aty ku kanë shfaqur më shumë interes pjesëmarrësit, do të përqendrohen edhe profesorët".

Në fund të gjashtë javëve të trajnimit përkthyesit dhe lektorët do të pajisen me certifikatë, e cila do të jetë një vlerë e shtuar në rrugën e tyre profesionale.






15 maj 2023

Java e katërt e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve në AZGJ

Sot në auditorët e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV, filloi java e katërt e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve. Temat që do të trajtohen janë: "Përkthimi i teksteve juridike" me ligjërues Prof. dr. Afet Mamutin dhe "Gramatika krahasuese ndërmjet shqipes dhe maqedonishtes", me ligjërues Prof. dr. Asllan Hamitin.

Në lidhje me temën "Përkthimi i teksteve juridike", për vetë specifikat e audiencës së përkthyesve dhe lektorëve, Prof. dr. Afet Mamuti tha :" Ajo që dua të theksoj në leksionin e sotëm, është fakti që gjatë përkthimit të ruhet kuptimi origjinal që ka teksti në gjuhën burimore", ndërsa shtoi se: "Trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve nga ana e AZGj-së është produktiv, sepse trajtohen problemet me të cilat ballafaqohen vetë përkthyesit" .

Prof. dr. Asllani Hamiti për temën "Gramatika krahasuese ndërmjet shqipes dhe maqedonishtes", sqaroi se: "Vëmendjen kryesore gjatë ligjëratës do ta përqendroj në ngjashmëritë dhe dallimet kryesore ndërmjet dy gjuhëve në fjalë dhe se ku duhet të orientohen përkthyesit dhe lektorët për përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, (fjalorëve elektronikë, shpjegimet e termave etj), në punën e tyre praktike.

Trajnimi i përkthyesve dhe lektorëve në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës do të vazhdojë edhe javën e ardhshme.



19 maj 2023

Në hapësirat e Drejtorisë së Udhëheqjes së Librave të Amzës realizuam takim pune me ekipin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, të udhëhequr nga drejtori i saj, z. Ardian Musliu.

Nga ata morëm mbështetje të parezervë në aspektin teknik për zbatimin e gjuhës shqipe në institucionin tonë.

I informuam se në suaza të burimeve që disponojmë si institucion, kemi avancuar shumë në drejtim të zbatimit të dygjuhësisë, mirëpo ky proces duhet edhe më tej të vazhdojë deri në përsosmëri maksimale profesionale.

U pajtuam që në të ardhmen gjithçka që kemi për përkthim dhe redaktim gjuhësor të termeve specifike, të përcillet në formë elektronike tek Agjencia, që të ketë efikasitet maksimal.

I falënderuam për mbështetjen që na japin dhe i siguruam se drejtoria si institucion dhe gjithë punonjësit bashkë, do japim maksimumin për zbatimin e dygjuhësisë në institucionin tonë.



19 maj 2023

Dygjuhësia së shpejti do të jetë në të gjithë dokumentet dhe formalitetet e tjera të Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë

Në takimin që patën zëvendësdrejtori i Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, Denis Aliti me drejtorin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ardian Musliun, ku merrnin pjesë dhe Këshilltarët shtetërorë të AZGj-së, Nebi Bilalli dhe Renata

Ballanca-Asani, u pajtuan që AZGj-ja të marrë përsipër përkthimin nga maqedonishtja në shqipe të gjithë dokumentacionin e agjencisë në fjalë.

Aliti tha se, “Duam që Gjuha Shqipe të gjejë zbatim në të gjitha nivelet e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, përfshirë këtu edhe njësitë rajonale, me theks të veçantë te certifikatat”.

Edhe pse vëllimi i punës i AZGj-së është i madh, drejtori premtoi se përkthyesit dhe lektorët, do të punojnë intensivisht për ta përmbushur kërkesën e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, në një afat sa më të shkurtë kohor.



23 maj 2023

QENDRA EUROPIANE E GJUHËVE MODERNE DHE AZGJ-JA AVANCOJNË BASHKËPUNIMIN

“Ndërtimi i edukimit shumëgjuhësh dhe ndërkulturor për demokracitë e shekullit të 21-të”. Është tema e leksioneve që Profesoresha Andrea Jang dha për përkthyesit, lektorët dhe gjuhëtarët e tjerë, të ftuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së. Profesoresha Andrea Jang është ligjëruese në Universitetin e Strasburgut në Fakultetin e Edukimit dhe mësimit gjatë gjithë jetës, ku ka një biografi të pasur në teorinë e gjuhësisë.

Drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, para se të fillonte aktiviteti, duke i dorëzuar zonjës Jang, një paketë me libra nga botimet studimore të AZGj-së theksoi: “Është nder dhe kënaqësi që pranuat ftesën e Agjencisë për të qenë pjesë e aktivitetit të organizuar në bashkëpunim me Qendrën Europiane të Gjuhëve Moderne në Grac të Republikës së Austrisë. Si një person që vij drejtpërdrejt nga sektori i arsimit dhe përvojës shumëvjeçare me studentët, është kënaqësi e veçantë që në ngjarjen e sotme, të trajtojmë me gjuhëtarët tanë, pikërisht temën e shumëgjuhësisë shumëkulturore në kontekstin e të sotmes”.

Koordinatori i projektit, Llazo Matovski, në lidhje me bashkëpunimin e AZGj-së me QEGjM-në, informoi: “Bashkëpunimi filloi një vit më parë, kur pas një thirrjeje publike ndërkombëtare nga qendra në fjalë, një delegacion i AZGj-së e vizitoi këtë institucion, i cili funksionon në kuadër të Këshillit të Europës. Më pas AZGj-ja aplikoi me projektin e saj, projekt që ka si përmbajtje qasjet pluraliste ndaj gjuhëve dhe kulturave”. Leksionet e profesoreshës Andrea Jang, u përqendruan te konceptet, çështjet, si dhe sfidat kryesore, referuar edukimit shumëgjuhësor e ndërkulturor për kulturën demokratike.

Në ligjërata përveç gjuhëtarëve të AZGj-së, morën pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Qendra e Edukimit Profesional, si edhe ligjërues të gjuhës nga institucione të ndryshme arsimore. Agjencia e falënderon Qendrën Europiane të Gjuhëve Moderne për bashkëpunimin e deritanishëm, duke qenë e hapur edhe për projekte të reja në të ardhmen.



25 maj 2023

Java e pestë e trajnimit në AZGj, trajton temën "Njohja e gjuhës dhe e terminologjisë profesionale, parakusht për përkthimin e specializuar"

Profesorët Arta Selmani dhe Izer Maksuti janë ligjëruesit, të cilët në kuadër të trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve nga institucione të ndryshme dhe administratës publike, do të japin këtë javë leksione në auditorët e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së.

Prof. dr. Arta Selimi, në lidhje me temën "Përkthimi ligjor (juridik)", ka vendosur të përfshijë një numër të madh termash profesionale nga disa fusha të jurisprudencës.

"Do të vë theksin në disa lëmi terminologjike, nga ato civile, administrative, kushtetuese, familjare, trashëgimore e deri tek ato penale e të tjera. Do të mundohem që brenda një grupi të audiencës të shpjegoj 400 terma juridikë".

Prof. dr. Izer Maksuti auditorit të përkthyesve dhe lektorëve do t'ua shpjegojë temën, "Përkthimi i teksteve të specializuara".

"Veçoritë e teksteve të specializuara nga fusha të ndryshme shkencore, do të jetë fokusi i leksionit tim. Do të ndalem në dy rrafshe, dallueshmëria ndërmjet tyre dhe si të lehtësojmë përkthimin. Përkthim do të thotë kuptim. Është pikërisht njohja e gjuhës profesionale dhe terminologjisë, si parakusht i përkthimit të specializuar".

Kontributi shtesë që jep AZGj-ja për përshpejtimin e procesit të zbatimit të dygjuhësisë në RMV, ju mundëson përkthyesve dhe lektorëve t'i njohin sa më mirë labirintet e gjuhës profesionale, për ta mundësuar zbatimin e saj sa më të qartë në praktikën e përditshmërisë.



30 maj 2023

Ku ka libra, dije ka. Temat që po trajtohen në javën e gjashtë të trajnimit në AZGj, kanë në thelb mjeshtërinë e përkthimit

Java e gjashtë e trajnimit të përkthyesve dhe redaktorëve gjuhësorë të ministrive dhe të administratës publike në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, filloi sot me leksionet e dy profesorëve të njohur nga Shqipëria, Prof. dr. Xhevat Lloshin dhe Dr. Dorian Koçin.

Prof. dr. Xhevat Lloshi, gjuhëtar dhe bashkëpunëtor i vjetër shkencor, si dhe njëri nga hartuesit e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, do të ligjërojë temën "Stilistika". Dr. Dorian Koçi, studiues dhe njohës i mirë i historisë, do të ligjërojë temën "Përkthimi i teksteve për artet dhe shkencat humane".

Prof. dr. Xhevat Lloshi, në intervistën paraprake tregoi se në leksionin e tij do ta shtjellojë mjeshtërinë e përkthimit, që vjen nga disiplina të tjera shkencore. "Sot nuk komunikohet me fjali, njerëzit komunikojnë me thënie, me tekste, prandaj përkthyesi si specialist, nuk ka kuptim të përkthejë fjali nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, por të përkthejë tekste nga një gjuhë në tekste të një gjuhe tjetër.

Dr. Dorian Koçi midis të tjerash tha: "Ne jemi të gatshëm t'ju ofrojmë ndihmën e duhur për gjithçka që kanë nevojë administratorët publikë të institucioneve tuaja".

Në takimin që pati drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, me profesorët e shquar, kërkoi prej tyre, që përtej trajnimeve të planifikuara të vazhdojnë ndihmën profesionale për të mbështetur AZGj-në, në misionin e saj historik të dygjuhësisë në RMV. Profesorët premtuan mbështetjen e tyre të parezervë.

Trajnimi i përkthyesve dhe i redaktorëve gjuhësorë në AZGj do të vazhdojë i ndarë në disa grupe për dy ditë me radhë.





6 qershor 2023

Sot u mbyll projekti vjetor i AZGj-së, për trajnimin e përkthyesve dhe lektorëve të ministrive dhe të administratës publike në RMV

Java e shtatë dhe e fundit e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve, të ministrive dhe të administratës publike të RMV-së, në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, u mbyll sot me leksionet e profesorëve Manjola Zaçellari, Nebi Bilalli dhe Lirim Shabani.

Dr. Manjola Zaçellari, pedagoge pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" - Durrës, autore e një sërë artikujsh shkencorë nga fusha e leksikologjisë, ligjëroi në temën ”Fjalët dhe shprehjet e huaja në Gjuhën Shqipe”.

“Duke pasur parasysh specifikën e auditorit, unë u përqendrova konkretisht në qëndrimin që duhet të mbajmë kundrejt fjalëve të huaja. Në aspektin praktik, analizuam disa tekste. Folëm gjithashtu edhe për ndikimin që ka anglishtja në gjuhën tonë dhe se vallë, a mund ta shohim shqipen si një gjuhë të hapur dhe dinamike” – u shpreh mes tjerash Dr. Manjola Zaçellari.

Prof. Nebi Bilalli, këshilltar shtetëror i përkthimit në AZGj, në leksionin e tij trajtoi temën “Terminologjia profesionale, veçoritë dhe karakteristikat”.

“Gjatë dy ditëve të leksioneve, përveç shpjegimit të temës, unë mora edhe shqetësimet që kanë punonjësit nëpër institucione dhe në administratën publike në vendin tonë, gjatë procesit të përkthimit. Nevojat e tyre i trajtuam së bashku, për të pasur një përkthim sa më profesional të dokumenteve, formularëve etj.”

Mr. Lirim Shabani, u shpreh se për ligjëratën e tij ka zgjedhur temën “Praktika e redaktimit”. “Me kandidatët bëmë konkretisht redaktimin e disa teksteve, të strukturës së fjalisë dhe të sintaksës, në mënyrë që të mos deformohet përmbajtja e materialit të përkthyer dhe të redaktuar”.

Ditën e fundit të trajnimit e përmbylli koordinatorja e projektit Prof. Shpresa Zeqiri Ibrahimi, e cila duke i përshëndetur trajnuesit dhe duke i falënderuar ata, tha:

“Gjatë këtyre 7 javëve janë mbajtur gjithsej 97 orë ligjërata, me tema konkrete që lidhen me përkthimin dhe lekturimin, ndaj mund të themi se trajnimi ka qenë i suksesshëm. Pjesëmarrja e kandidatëve ka qenë e lavdërueshme gjithashtu”.

Drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, gjatë bisedës që pati me profesorët dhe me koordinatoren e trajnimit, mes tjerash theksoi:

“Ne si AZGj e vlerësojmë faktin që me këtë projekt, si një nga detyrat tona si institucion që kujdeset për zbatimin e gjuhës, t’u kemi ardhur në ndihmë përkthyesve dhe lektorëve të institucioneve dhe administratës publike në RMV, lidhur me procesin e dygjuhësisë”.

Projekti i trajnimit, organizuar nga AZGj-ja, ishte i treti me radhë dhe do të vazhdojë edhe vitin tjetër me të njëjtin intensitet dhe përkushtim profesional.






Агенција за примена на јазиците на РСМ
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
Language Implementation Agency of RNM





8 qershor 2023

AZGj-a ndau certifikata për punonjësit e administratës, të cilët ndoqën trajnimin për përkthyes dhe lektorë

Pas 7 javësh ligjërata intensive për trajnimin e përkthyesve dhe lektorëve nga ministritë dhe administrata publike në RMV, në auditorët e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, u bë ceremonia e ndarjes së certifikatave, ku 65 administratorë u pajisën me motivacionin për kryerjen me sukses të kursit të trajnimit për përkthim dhe lekturë.

Koordinatorja prof. Shpresa Zeqiri Ibrahimi, tha "Ky është viti i tretë që AZGj-ja organizon ligjërata me tema për përkthim profesional të gjuhës nga profesorë të njohur nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova. Edhe këtë vit trajnimi u mbyll me sukses".

Fjalën e rastit e mbajti drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, i cili i uroi kandidatët, duke theksuar se "Ju jeni ata që e shtyni dhe e përshpejtoni më tepër procesin e rëndësishëm të dygjuhësisë. Gjuha shqipe është shenja dalluese themelore e identitetit tonë".

Së fundi u ndanë certifikatat për secilin administrator. Certifikata është një vlerë e shtuar për kandidatët dhe dëshmi për profesionalizmin e përkthyesve dhe lektorëve.


ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA





21 korrik 2023

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, e vazhdon punën për t'i dorëzuar në afatet e parapara kohore materialet e pranuara për përkthim dhe redaktim gjuhësor nga institucione të ndryshme shtetërore

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, e vazhdon punën për t'i dorëzuar në afatet e parapara kohore materialet e pranuara për përkthim dhe redaktim gjuhësor nga institucione të ndryshme shtetërore. Materiali vëllimor, përkthimi i 2000 pyetjeve për udhëheqës administrativë, është në përfundim e sipër. Temat e studimeve të rastit, do t'i dorëzohen Agjencisë së Administratës -MSHIA, në fillim të gushtit.



21 korrik 2023

Në fillim të korrikut, AZGj-ja ia dorëzoi Ministrisë së Bujqësisë të Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave, përkthimin dhe redaktim në gjuhën shqipe të qindra faqeve të Ligjit të Gjuetisë, gjithashtu një material vëllimor, i cili iu nda për përkthim një grupi përkthyesish dhe lëktorësh, për të qenë korrekt me afatin e paracaktuar të dorëzimit të ligjit.

Ndërkohë janë në përfundim e sipër në përkthim në gjuhën shqipe, dhjetëra formularë të Komisionit Rregullator të Energjetikes – KRRE, të cilat u pranuan gjatë kësaj jave nga AZGj-ja dhe do të dorëzohen po brenda javës.




21 korrik 2023

AZGj-ja vazhdon punën me përkthyes dhe lektorë nga institucione të administratës publike dhe ministrive, të cilët kërkojnë ndihmë për t'u trajnuar dhe konsultuar.

Ndërsa një tjetër moment i procesit të punës në AZGj, në këto ditë korriku, janë edhe lekturimet dhe redaktimet gjuhësore urgjente të përkthimeve në gjuhën shqipe të materialeve që vijnë rregullisht nga Kuvendi i RMV-së.

Ndërsa shkollat, teatrot dhe institucionet tjera, dërgojnë vazhdimisht në agjenci materiale për përkthime të shkurtra dhe të shpejta.



26 shtator 2023

Vazhdon bashkëpunimi mes AZGJ-së dhe UT-së

Drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, Këshilltarin shtetëror të përkthimit dhe kabinetin, me ftesë të dekanit të Fakultetit të Filologjisë, Prof. dr. Berton Sulejmanit, u takuan me Prorektorin e bashkëpunimit ndërkombëtar, Prof. dr. Salajdin Saliun dhe Prof. dr. Izmit Durmishin.

Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. Berton Sulejmani, me këtë rast e njoftoi drejtorin për akreditimin e programit të ri studimor në UT, Redaktim gjuhësor, në ciklin e dytë të studimeve, një mundësi më shumë kjo, për të gjithë të interesuarit për t'u specializuar në fushën e redaktimit gjuhësor.

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ardian Musliu, shprehu mirënjohjen e tij për punën fisnike që po e bën Universiteti i Tetovës, konkretisht Fakulteti i Filologjisë, duke theksuar se ky program i ri studimor në fushën e Redaktimit gjuhësor, do t'i zbusë mangësitë gjuhësore nëpër institucione, në mungesë të lektorëve të specializuar. Drejtori Musliu shfaqi gatishmëri për të mirëpritur në AZGj, për punë praktike, të gjithë studentët e këtij programi studimor, duke marrë parasysh faktin se AZGj-ja më herët ka nënshkruar edhe memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Tetovës.





28 shtator 2023

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, këshilltari shtetëror i përkthimit z. Nebi Bilalli, në një intervistë për Radio Televizionin Shtetëror, kanali i dytë në gjuhën shqipe dha detaje për publikun lidhur me Konferencën shkencore në organizim të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ).



29 shtator 2023

AZGj-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit

Me konferencën shkencore me sloganin "Agjencia deri më sot ka përkthyer dhe lekturuar 100.000 faqe", Agjencia e Zbatimit të Gjuhës në RMV shënoi sot Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit. Ishin të pranishëm rektorë, zëvendësrektorë, dekanë, drejtorë, shefa katedrash, media, si edhe punonjësit e AZGj-së.

Pjesa solemne filloi me fjalën e rastit që mbajti drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu. Konferencën e përshëndetën Nebi Bilalli – këshilltar shtetëror i përkthimit,

Salajdin Salihu – prorektor në UT, Ajten Hajdari-Qamili – profesoreshë e gjuhës shqipe, Ylber Sela – ish-drejtor i AZGj-së.

Në pjesën e dytë të Konferencës profesorë dhe përkthyes profesionistë prezantuan punimet e tyre me temën "Agjencia dhe sfidat e saj të përkthimit dhe të lekturimit". Në foltore ligjëruan Ahmet Selmani – këshilltar shtetëror i redaktimit gjuhësor, Nebi Bilalli – këshilltar shtetëror i lekturës, Berton Sulejmani – Dekan i Universitetit të Tetovës, Ajten Hajdari-Qamili – profesoreshë në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi", Llukrecija Malkoviq-Atanasovska – Kryetare e Shoqatës së Përkthyesve, Lindita Bilal-Abdullahu – përkthyese, Arsim Jonuzi – përkthyes, Liljana Pandeva – lektore në AZGj.

Në fund pati edhe debate në lidhje me detajet e përkthimit profesional si veprimtari intelektuale që mundëson komunikimin jo vetëm midis institucioneve, por edhe midis vetë qytetarëve të RMV-së. Manifestimi i Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit është një traditë të cilën AZGj-ja e feston qysh nga themelimi i saj.





29 shtator 2023

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË AZGJ-së NË SHËNIMIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË PËRKTHIMIT

Sot kemi nderin e veçantë dhe detyrimin institucional që ta shënojmë Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit, ditë kjo të cilën, më 24 maj të vitit 2017, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e shpalli si të tillë, duke zgjedhur 30 shtatorin si datë për shënimin e saj.

Duke qenë në krye të një institucioni, siç është Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, e cila ka detyrim ligjor që t'i ndihmojë institucionet shtetërore për zbatimin praktik të gjuhës shqipe, e kjo nënkupton edhe përkthimin e tyre nga maqedonishtja në shqip, aq më tepër na takon që të jemi pjesë e një solemniteti të këtillë, ku me disa aktivitete modeste përkujtohet kjo ditë duke folur e debatuar për çështjen e përkthimit nga njëra gjuhë në tjerën dhe anasjelltas.

Me këtë rast dëshiroj të theksoj se përkthimi si veprimtari intelektuale dhe kreative është shumë specifik dhe madhor njëkohësisht, për arsye se mundëson komunikim ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve brenda Maqedonisë së Veriut.

Prandaj, në këtë rast ne kemi privilegjin dhe përgjegjësinë që ta realizojmë këtë deri në nivelet më të larta shtetërore, duke krijuar mundësi dhe forma të komunikimit të shkruar dhe të folur për ata që punojnë në institucionet përkatëse, si dhe, veçanërisht, për qytetarët që u drejtohen atyre për nevojat e tyre.

Gjithsesi, këtë mundësi nuk do ta kishim pa Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, i cili u miratua me konsensus të gjerë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke kapërcyer shtigje e duke hapur rrugë më të gjera në rrafshin e komunikimit shumëgjuhësh brenda këtij shteti ku jetojmë dhe veprojmë si qytetarë dhe si shtetas të tij.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës deri tani ka bërë një punë të lakmueshme në këtë aspekt, duke u përballur me sfida të mëdha për sa i përket përkthimit dhe duke i tejkaluar ato me sukses, pra duke i ndihmuar institucionet shtetërore në përkthimin e shkresave të ndryshme administrative, akteve ligjore, rregulloreve e dokumenteve, formularëve të shumtë për nevojat e qytetarëve etj. Pa dyshim, këtë punë do të vazhdojë ta bëjë edhe më tej duke u ndodhur gjithmonë në krye të detyrave dhe duke i realizuar ato nga kolegët tanë të cilët tashmë janë stërvitur dhe profesionalizuar për këtë punë.

Uroj që shënimi i kësaj dite, në radhë të parë, të jetë një thirrje dhe një mesazh për t'i respektuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, pra gjuhët e ndryshme të cilat jetojnë dhe përdoren pranë njëjra-tjetrës, siç janë shqipja dhe maqedonishtja, të cilat patjetër duhet të gjejnë mënyra adekuate dhe të krijojnë harmoni të plotë qytetare. Natyrisht, kjo frymë do të na bëjë më të lirë dhe më demokratikë, që një ditë gjërat të rrjedhin natyrshëm, pa pasur nevojë për përkthim, thjesht duke komunikuar secili në gjuhën e vet dhe duke e kuptuar tjetrin në gjuhën e tij. Kjo nuk është utopi, por vizion qytetar.Gëzuar Dita Ndërkombëtare e Përkthimit!



12 tetor 2023

Sqarim rreth gabimit të bërë në tabelën rrugore të vendosur në Strugë

Gjatë ditëve të fundit, në Strugë është vendosur një tabelë rrugore me ç'rast emri i fshatit Ladorisht është shkruar "Radolishta", pra me gabim te versioni shqip.

Konsiderojmë se reagimi i qytetarit të Strugës në portalin "Strugalajm" është i drejtë, mirëpo sqarojmë opinionin se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) ka redaktuar tabelën dhe ka lënë versionin e saktë, pra "Ladorisht". Pra, bëhet fjalë për lëshim që është bërë nga ana e prodhuesit të tabelës. Gabimi i njëjtë është bërë edhe me Frëngovën.

Gjithashtu, si Agjenci kemi rekomanduar që renditja gjuhësore të jetë maqedonisht, shqip, anglisht dhe jo ashtu siç e praktikon Ministria e Punëve të Brendshme.

Kërkojmë dhe shpresojmë që ky gabim të përmirësohet sa më parë dhe që nuk do të përsëritet më.



25 tetor 2023

Vizitë studimore e delegacionit nga Kosova në AZGj

Një delegacion i përbërë nga, Sllavisha Mlladenoviq, komisioner i Zyrës për Gjuhët, Mentor Borovci, drejtor i Zyrës Ligjore, Arta Pllana, koordinatore për komunikim, Safete Grajçevci, koordinatore për sigurimin e zbatueshmërisë, Agron Gashi, koordinator, Zyra Ligjore, Shaban Ademi, drejtor i Zyrës për buxhet dhe financa, Nexhmije Xani, drejtuese e burimeve njerëzore, Kefsere Baliu, drejtuese për buxhet dhe financa, Xhavit Bulliqi, zyrtar i lartë ligjor vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGj).

Delegacioni u prit nga drejtori i Agjencisë, Ardian Musliu, i cili i njoftoi lidhur me Agjencinë dhe tregoi për avancimin e zbatimit të gjuhës në RMV.

Në ditën e parë kolegët nga Kosova u informuan nga përfaqësuesit e AZGj-së për gjithë ciklin e procesit të përkthimit. Protokolli vazhdoi me informacionin e përgjegjësve të sektorëve në AZGj, Shpresa Zeqiri-Ibrahimi dhe Marjan Patlixhankovski, të cilët shpjeguan mënyrën e funksionimit dhe ndërtimit të Agjencisë. Ndërsa Sllavisha Mlladenoviq nga Kosova, tha: "Ne kemi ardhur këtu, për të parë një model nga mënyra e zbatimit të dygjuhësisë, për ta pasur më të lehtë të ndërtojmë një institucion të ngjashëm edhe në Kosovë".

Dita e parë e vizitës u mbyll me nënshkrimin e një memorandumi dypalësh midis drejtorit të AZGj-së, Ardian Musliu dhe kryesuesit të delegacionit nga Kosova, Sllavisha Mlladenoviq.

Ditën e dytë të diskutimeve studimore me delegacionin nga Kosova e drejtoi këshilltari shtetëror Nebi Bilalli, i cili foli për sektorin e përkthimit dhe të lekturës. Ndërsa, Jeton Sulejmani, këshilltar shtetëror i bashkëpunimit me Qeverinë dhe marrëdhënieve me publikun, Teuta Hiseni, zv.udhëheqëse e sektorit të përkthimit dhe të lekturimit, Ahmet Selmani dhe Renata Ballanca Asani këshilltarë shtetërorë të redaktimit dhe lekturimit gjuhësor, prezantuan procesin e punës në sektoret përgjegjëse.

Diskutimet vazhduan me pyetje dhe përgjigje ndërmjet të pranishmëve. Më pas delegacioni vazhdoi vizitën në Inspektoratin e përdorimit të gjuhëve.



8 nëntor 2023

Punonjësit e AZGj-së ndoqën trajnimin treditor lidhur me përforcimin e punës ekipore

Prej 1 deri më 3 nëntor në Mavrovë, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, organizoi trajnim lidhur me menaxhimin e stresit në vendin e punës, si dhe për forcimin e punës ekipore, në të cilin punonjësit e saj ndoqën me vëmendje të veçantë ligjëratat dhe stërvitjet nga ana e trajnuesve të autorizuar nga institucione kompetente.

Trajnimin në fjalë e hapi drejtori i AZGj-së, Ardian Musliu, i cili theksoi nevojën dhe rëndësinë e komunikimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet të punësuarve, si dhe për tejkalimin e vështirësive gjatë procesit të punës.

Këtë trajnim e mbajti Litera academy nga Tetova, ku përfaqësuesit e saj në mënyrë interaktive zhvilluan dialog me punonjësit e AZGj-së me pyetje dhe përgjigje, si dhe me shpjegime përkatëse për situatat e ndryshme gjatë punës së përditshme.

Me këtë rast u theksua nevoja e krijimit të vetëdijes për menaxhimin e stresit në mënyrë që të arrihet edhe efikasitet i plotë në punë. Po ashtu, ata theksuan në veçanti edhe krijimin e frymës ekipore në punë, frymë kjo e cila paraqet çelësin e suksesit dhe të efikasitetit në arritjen e qëllimeve gjatë punës.

Në fund, punonjësve të AZGj-së, të cilët morën pjesë në këtë trajnim, iu ndanë edhe nga një certifikatë për ndjekjen e tij.




Team
Building
Training
Lifelong learning
is no longer
a luxury
but a necessity
for employment

9 nëntor 2023

Përdorimi i gjuhës shqipe edhe në gjyqësor

Ka filluar procesi i përdorimit të gjuhës shqipe edhe në procedurat gjyqësore në RMV. Në këtë kuadër përfaqësues të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës u ftuan në Institucionin e Avokaturës së Shtetit, për të rënë dakort për redaktimin profesional gjuhësor të teksteve dhe të procedurave të tjera gjyqësore.

Avokati i Shtetit, Agron Reçi, dhe bashkëpunëtorja e përkthimit Xhejlane Halimi, i pritën në hapësirat e Avokaturës së RMV-së, përfaqësuesit e AZGj-së, drejtorin Ardian Musliun, përgjegjësin e përkthimit dhe të redaktimit gjuhësor, Nebi Bilallin, këshilltarin shtetëror të bashkëpunimit me qeverinë dhe marëdhëniet me publikun, Jeton Sulejmanin dhe përfaqësuesen e kabinetit të drejtorit Nerxhivane Kuqin.

Z. Reçi nga pozicioni i avokatit të Avokaturës së Shtetit, kërkoi nga përfaqësuesit e AZGj-së, të redaktojnë një numër të konsiderueshëm shkresash dhe tekstesh delikate të akteve, procedurave e formaliteteve të tjera gjyqësore, që janë në kompetencë të Avokaturës së Shtetit të RMV-së, në gjuhën shqipe.

Nga ana e AZGj-së u zotuan se do të lekturohen dhe do të redaktohen me përgjegjesi profesionale të gjitha materialet që do të dërgohen, e gjith kjo në funksion të zbatimit sa më të shpejtë të gjuhës shqipe edhe në këtë fushë të administratës gjyqësore.

Me këtë bashkëpunim midis AZGj-së dhe Avokaturës së Shtetit, avancohet në një stad më të lartë procesi i dygjuhësisë në RMV.



24 nëntor 2023

Përfaqësues të AZGj-së morën pjesë në Samitin e III të Diasporës Shqiptare në Tiranë

Me ftesë të organizatorëve të Samitit të Tretë të Diasporës Shqiptare, përfaqësues të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, me në krye drejtorin Ardian Musliu, qëndruan në Tiranë për t'i ndjekur punimet e Samitit.

Samiti filloi paraprakisht me Ditën e Arbëreshëve në një datë simbolike, 22 Nëntorin, dita kur në Manastir u mbajt Kongresi i Manastirit. Përfaqësuesit e AZGj-së, jo vetëm ndoqën aktivitetet e traditës arbëreshe, por vendosën kontakte për rrugët e bashkëpunimit me të gjitha komunat arbëreshe në jug të Italisë, për të ofruar ndihmë profesionale në ruajtjen e gjuhës, bashkëpunim që do të përfshijë avancimin e gjuhës shqipe tek arbëreshët e Italisë.

Në ditën e dytë të Samitit, përfaqësuesit e AZGj-së, përveç manifestimit qëndror në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, i ndoqën gati të gjitha panelet, me tema të ndryshme diskutimesh, rreth bashkëpunimit ndërmjet diasporës shqiptare nëpër botë. Ndërkohë, u përqëndruan te paneli i organizuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit e Shqipërisë, ku tema kryesore ishte gjuha shqipe, në veçanti arsimi në përgjithësi.

Në vijimësi në foltoren e Samitit të Tretë të Diasporës, u ngjitën personalitete nga Shqipëria dhe diaspora, si dhe emra të njohur shqiptarësh, të cilët përcollën kryesisht mesazhet e tyre me një thelb të rëndësishëm të përbashkët, për të shkruar një faqe të re bashkëpunimi me synime të përbashkëta.

Në Samit kishte një pjesëmarrje shumë të madhe të udhëheqësve më të lartë nga shtetet shqiptare, apo shqiptarë shtetëformues, si dhe njerëz me ndikim në diasporë, të suksesshëm në veprimtaritë e tyre, të cilët ngrenë imazhin e popullit tonë kudo nëpër botë.


SAMITI I DIASPORËS
SAMITI III
DIASPORËS
23 NËNTOR 2023



REKOMANDIME

- Të gjithë organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, t'i zbatojnë detyrimet e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.
- Realizimi i detyrimeve, para së gjithash, nënkuptohet ndërtimi i kapaciteteve të kuadrit dhe ato teknike në suazat e organeve (angazhimi i përkthyesve dhe lektorëve të kualifikuar, sigurimin e softuerit të përkthimit etj.) Të gjithë organet në aktin e tyre të sistematizimit dhe organizimit të brendshëm të vendeve të punës të, parashohë forma organizative/vende të punës për përkthyes dhe interpretues në dhe nga gjuha shqipe.
- Të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e problemit me mungesën e lektorëve të gjuhës shqipe, duke pasur parasysh se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston institucion kompetent për realizimin e provimit për lektor të gjuhës shqipe dhe lëshimin e licencave për lektorë të gjuhës shqipe.
- Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë, të krijojë politika nëpërmjet të cilave do të rritet atraktiviteti për regjistrim në katedrat e gjuhës dhe të letërsisë shqipe (drejtimi përkthim dhe interpretim) në institucionet publike të arsimit të lartë (për shembull, nëpërmjet rritjes së kuotave të regjistrimit, ndarjen e bursave të studimit dhe suksesit të arritur, punësimi i garantuar/stazhionimi me prioritet për punësim në sektorin publik etj.)
- Orvatjet e autoriteteve të drejtësisë të drejtohen nga ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve për përdorimin efektiv dhe efikas të gjuhëve në procedurat gjyqësore, administrative, procedurat e përmbarimit, procedurat e ekzekutimit të sanksioneve, procedurat hetimore dhe parahetimore, si edhe procedura të tjera para gjyqeve, prokuroritë publike, si edhe të gjithë organet e tjera të gjyqësisë, trupa dhe institucione.
- Ndërtimi i konceptit të shoqësisë së barabartë për të gjithë qytetarët medoemos duhet të ketë reflektim në arsim, duke filluar nga ai fillor, nëpërmjet reformave të mësimit të gjuhës së bashkëqytetarit tënd, si mjet kryesor komunikimi, bashkëjetesë dhe kuptim i ndërsjellë.

- Të sigurohet respektim i tërësishëm i detyrimit ligjor të publikimeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" të ligjeve, akteve nënligjore, vendimet dhe shpalljet nga institucionet e pushtetit shtetëror, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj.
- Të gjithë institucionet kompetente t'i harmonizojnë aktet e veta të brendshme
me dispozitat gjuhësore të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.
- Institucionet që punojnë nëpërmjet sportelit/pultit, të sigurojnë që personat që punojnë në sportel/pult të kenë njohuri të të dy gjuhëve zyrtare.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i intensifikojë aktivitetet e ngritjes së vetëdijes publike, për zbatimin e vendimit ligjor të gjuhëve, si rregull pozitiv ligjor dhe t'i drejtojë aktivitetet e veta nga forcimi i konceptit qytetar të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët.

AZGJ-ja do të vazhdojë edhe më tutje me punën e saj të vazhdueshme të jetë një lexues aktiv institucional në aspektin e zbatimit efikas dhe efektiv të kompetencave të veta në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, njëherësh, një vazhdimësi, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

rr. “Filipi i Dytë i Maqedonisë” nr. 11, kati i 3-të

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Ky raport është publikuar në mars të vitit 2024.

I qasshëm është në maqedonisht, në shqip dhe në anglisht.